Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Menaxhmenti Strategjik i Biznesit **zgjidhjet**	**P12**

Problem 1

1. Korporata Alpha Fashion eshte korporate multinacionale e cila shtrin aktivitetin në shume vende të BE-së dhe veprimtari primare ka prodhimin e produkteve kozmetike dhe linjave të tretmaneve për lëkurë.

Në takimin e fundit të kuvendit të akcioneëve bordi i korporatës është udhëzuar që të orientojë strategjinë në dy drejtime:

a) Të filloj procesin e përgatitjes së të gjitha procedurave të qeverisjës dhe strategjisë korporative për ta bërë gati korporatën për tu listuar në berzë;

b) Të filloj të gjitha procedurat për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe të gjejë praktika të qëndryeshme mjedisore në prodhimin linjës komzetike dhe produkteve tjera medicinale.

Drejtori ekzekutiv (DE) i korporatës është Erion Xhoni i cili është i njohur për apetit e tij për maksimizimin e fitimit duke zgjedhur strategji agresive të shtrirjes së biznesit duke minimizuar kostot pa zgjedhur shumë praktikat mjedisore e sociale.

Bordi i drejtorëve udhëhiqët nga përfaqësuesi i akcionerëve Kryesuesja Ekzekutive (KE) Lejla Mita e cila nuk shquhet shumë për involvimin e saj dhe është shumë e mbështetur në punën e DE-se.

Çështjet për t'u konsideruar:

- Edhe përkundër udhëzimeve të qarta nga kuvendi i akcionerëve, KE dhe DE nuk kanë ndërmarrë asgjë sa i përket zbatimit të praktikave të qëndrsueshme mjedisore. Alpha vazhdon duke përdorur lëndën e parë me bazë shtazore dhe bimore duke mos konsideruar ndikimin mjedisor. Për më shumë produktet vazhdojnë të testohen tek kafshët tjera duke mos ju përmbajtur udhëzimeve të organizatave për mbrojtjen e kafshëve.

- Produktet e Alpha të linjës së trajtimit të fëtyrës janë terhjekur nga tregu në disa shtete për asye se ato kanë pasur përmbajtje të materieve të cilat janë dëshmuar se mund të dëmtojnë lëkurën pas përdorimit afatgjatë. Në këto produkte nuk kishte asgjë të shkruar kundër përdorimit afatgjatë. Në disa shtete kanë filluar paditë e konsumatorëve kundër korporatës për dëmitime serioze.

- Një linjë e produkteve të Alpha vazhdojnë të prodhohen në vendet aziatike pa respektuar kodet e punësimit të miturve. Sipas shumë raporteve ndërkombëtare kostoja e fuqisë punëtore ishtë shumë ulët për këto linja prodhimi gjë që ngre dyshime të qarta se kemi të bëjmë më punësim të minorenëve dhe trajtimi jo i mirë I fuqisë punëtore.

- Politika dhe strategjia e korporatës së Alpha e udhëhequr nga DE është e bazuar në rritje të fitimit të korporatës në mënyrë agresive. Alpha si rezultat ka pasur një rritje të jashtzakonshme për shkak të një marketing agresiv duke përdorur mediat sociale e cila

kryesisht targeton moshën e re e tek të cilët nuk ka shumë rëndësi kualiteti dhe aspektet shëndetësore

- KE zakonisht fton takimet e bordit në afat shumë të shkurtër pa ndonjë përgatije paraprake dhe se të gjitha materialet përgatiten nga DE të cilat mirren si të mirëdhëna. Politika e bonuseve dhe shpërblimeve të DEsë aplikohet zakonisht ashtu siq edhe propozohet nga menaxhmenti. Kohëve të fundit 3 herë është ndërruar Drejtori Financiar më rekomandim të DE-së. Komiteti i auditimit takohet dy herë në vit dhe kanë aprovuar raportet financiare dhe opinionin e auditorit pa diskutuar. Komiteti i auditimit përbëhet nga asistenti ekzekutive i DE, drejtori i shitjes dhe menaxheri i marketingut.

- Auditorët e korporatës në selinë e korporatës janë firma Axel Audit e cila firmë arketon 30 përqind të të hyrave nga auditimi prej Alpha si klient i tyre. Me kërkesë të DE-së Axel Audit kishte asistuar në përzgjedhjen e firmave të auditimit në vendet ku shtrihet Alpha. Për këtë shërbim Axel Audit ishte kompenzuar. Axel Audit kishte kryer edhe shërbime vlerësimi për dy kompani tjera të cilat ishin blerë nga ana e Alpha.

- Në takimet e kuvendit të akcionerëve, akcionerët e vegjël nuk ishin ftuar në takim dhe se vendimet e marra ishin marrë pa u konsultuar paraprakisht me ta nën arsyetimin se vota e tyre nuk qon peshë meqenëse ishin shumë pak vota.

Kërkohet:

a) Duke shtjelluar legjilsacionin e "Sarbanes Oxley Act" diskutoni çështjet kyçe të korporatës Alpha. (5 pikë)

b) Çfarë janë kërkesat kryesorë që kjo korporatë sipas këtij legjislacioni do të duhet përmbushur për t'u listuar në berzë. (5 pikë)

c) Duke spjeguar kodet kryesore të qeversijes korporative sqaroni se cfarë ceshjet secila prej tyre kanë adresuar duke perdorur kontekstin e Korporatës Alpha? (10 pikë)

Total 20 pikë

Zgjidhja

a. Ligji i Sarbanes-Oxley i vitit 2002 është një ligj federal që vendosi rregullore gjithëpërfshirëse të auditimit dhe financiare për kompanitë publike. Ligjvënësit krijuan legjislacionin për të ndihmuar në mbrojtjen e aksionarëve, punonjësve dhe publikut nga praktikat mashtruese financiare. Auditorët, kontabilistët dhe zyrtarët e korporatave u bënë përgjegjës për grupin e ri të rregullave. Këto rregulla ishin amendamente dhe shtesa në disa ligje të zbatuara nga Komisioni i Letrave me Vlerë (SEC), duke përfshirë Aktin e Letrave me Vlerë dhe Shkëmbime të vitit 1934 (Akti i Shkëmbimit) dhe Aktin e Këshilltarëve të Investimeve të vitit 1940. SEC zbaton Aktin Sarbanes-Oxley. Fushat kryesore në të cilat fokusohet ligji janë:

- Rritja e dënimit penal
- Rregullorja e kontabilitetit
- Mbrojtje të reja
- Përgjegjësi e korporatës

Akti synonte kryesisht të rregullonte raportimin financiar, auditimet e brendshme dhe praktikat e tjera të biznesit në kompanitë e tregtuara publikisht. Megjithatë, disa dispozita zbatohen për të gjitha ndërmarrjet, duke përfshirë kompanitë private dhe organizatat jofitimprurëse.

Për më tepër, ligji vendosi gjoba për mospërputhje me dispozitat e tij. Pajtueshmëria me ligjin ka të bëjë me zbulimin financiar dhe qeverisjen e korporatës.

Implikimet e legjislacionit të SOX janë kryesisht të ndërlidhura me çështje të auditimit dhe raportimit financiar e në këtë drejtim me transparencën financiare.

- Auditorët e korporatës në selinë e korporatës janë firma Axel Audit e cila firmë arketon 30 përqind të të hyrave nga auditimi prej Alpha si klient i tyre. Kjo në vetevete është në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit sepse një firmë auditimi nuk lejohet të ketë mbi 20 përqind të hyrave nga një klient i vetëm.
- Me kërkesë të DE-së Axel Audit kishte asistuar në përzgjedhjen e firmave të auditimit në vendet ku shtrihet Alpha. Për këtë shërbim Axel Audit ishte kompenzuar. Kjo gjithashtu është në kundërshtim me legjislacionin SOX sepse nuk lejohen shërbime shtesë për auditorët përveç një numri shumë të limituar të shërbimeve.
- Axel Audit kishte kryer edhe shërbime vlerësimi për dy kompani tjera të cilat ishin blerë nga ana e Alpha. Gjithashtu ky shërbim është i ndaluar në mënyrë specifike.
- Gjithashtu Alpha Fashion duhet të jetë shumë transparentë ndaj padive të mundshme për praktikat e tyre të afarizmit që cenojnë të drejtat e kafshve si dhe për shkak të punësimit të minorenëve.

b. Kërkesat kryesorë që kjo korporatë sipas këtij legjislacioni do të duhet përmbushur për t'u listuar në berzë:

Auditorët duhet të rishikojnë sistemet e kontrollit të brendshëm.

Duhet të ketë rotacion të partnerëve drejtues ose rishikues çdo pesë vjet.

Audituesve iu ndalohet shprehimisht të kryejnë shumicën e shërbimeve jo audituese.

Komitetet e auditimit duhet të jenë përgjegjës për emërimin, kompensimin dhe mbikëqyrjen e auditorëve.

Të gjithë anëtarët e komiteteve të auditimit duhet të jenë të pavarur dhe të paktën një anëtar duhet të jetë ekspert financiar.

Raportet vjetore duhet të përmbajnë raporte të kontrollit të brendshëm (raportet s404) që deklarojnë përgjegjësinë e menaxhmentit për krijimin dhe ruatjen e një strukture dhe procedurash adekuate të kontrollit të brendshëm për raportimin financiar dhe vlerësojnë efektivitetin e tyre.

Kryeshefi ekzekutiv dhe shefi i financave duhet të vërtetojnë përshtatshmërinë e pasqyrave financiare.

c. Kodet kryesore dhe konteksti I korporatës Alpha.

Kodi	**Ceshtja qe mbulohet**	**Te gjeturat tek EU-NI**
Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) zhvilloi Parimet e saj të Qeverisjes së Korporatave	Të drejtat dhe trajtimi i barabartë i aksionarëve dhe funksionet kryesore të pronësisë	Tek Alpha ekziston nje tendence e mbivotimit te akcionereve te vegjel si dhe nuk ka nje system transparent te vendim marrjes e cila do ti njoftonte akcioneret e vegjel per procesin e vendim marrjes.
Akti Sarbanes-Oxley 2002 (SHBA)	Auditorët duhet të rishikojnë sistemet e kontrollit të brendshëm. Duhet të ketë rotacion të partnerëve drejtues ose rishikues çdo pesë vjet. Audituesve iu ndalohet shprehimisht të kryejnë shumicën e shërbimeve jo audituese.	Procesi i zgjedhjes se auditoreve te jashtem nuk ishte transparente dhe se I eshte lene ne diskrecion te DE-se. Ky process duhet te udhehiqet ne menyre transparence me perfshirjen e komitetit te auditimit, duhet siguruar qe auditoret jane te pavarur dhe se kompenzohen ne menyre te drejte per punen e bere. Duhet siguruar qe te mos jepen sherbime tjera

		pervec sherbimeve te auditimit.
Raporti i Mbretit i Afrikës së Jugut	Qasje të integruar për qeverisjen e korporatës në interes të një game të gjerë palësh të interesuara – duke përfshirë aspektet sociale, mjedisore dhe ekonomike të aktiviteteve të një kompanie	Alpha nuk ka nje qasje te integruar. Problematike eshte ceshtja mjedisore dhe ndikimit ne komunitet. Duhet te kete nje raportim te inegruar per ceshtje mjedisore, sociale dhe qeverisjes.
Kodi i Qeverisjes së Korporatave të Singaporit	Përqindja tipike e drejtorëve të pavarur (joekzekutiv) në bord Të paktën një e treta, por duhet të jetë gjysma nëse kryesuesi nuk konsiderohet i pavarur	Eshte e paqarte se sa drejtore jo ekzekutiv jane ne bord te Alpha dhe se ata jane ne ndikimin e DE, prandaj verehet se ata nuk veprojne si te pavarur ne interes te te gjitha akcionereve.
Raporti Cadbury (1992)	Përmblodhi përfitimet që një komitet auditimi mund t'i sjellë një organizate: "Nëse funksionojnë në mënyrë efektive, komitetet e auditimit mund të sjellin përfitime të rëndësishme.	Komiteti I auditimit nuk eshte I pavarur por perbehet prej stafit te perhereshem dhe dy prej tyre jo-kompetent. Ky komitete ekziston vetem figurativisht dhe se nuk ka rol demethenes. Ata nuk kane takime te rregullta por verehet se punen e bejne vetem formalisht.
Kodi i Qeverisjes së Korporatave në Mbretërinë e Bashkuar (2018)	Komitetet e shpërblimit duhet të përfshijnë vetëm DJE-të dhe gjithashtu duhet të marrin parasysh sa vijon: Strategjia e mbështetjes: Nevoja për transparencë: Nevoja për gjykim E lidhur me performancën	Shperblimet jane jo – transparente e sidomos bordi jane ne ndikim te DE. Nuk ka nje system te kompenzimit dhe kjo behet sipas tekeve te DE.

Problemi 2.

Diagrami/Kubin COSO:

a) Spjegoni diagramin dhe detajoni veçoritë e një kornize të kontrollit të brendshëm? (4 pikë)
b) Vizatoni diagramin dhe përshkruani secilin element në kontekstin e Alpha Fashion? (4pikë)
c) Përshkruani format më të zakonshme të aktiviteteve të kontrollit të cilat mund të instalohen në departamentin e shitjes ne Alpha Fashion ? (4 pikë)
d) Përmendi nga 3 rreziqe strategjike dhe rreziqe operacionale të Alpha Fashion? (4 pikë)
e) Identifikoni se cilat janë rreziqet nga kultura e DE të Alpha Fashion? (4 pikë)

a. Korniza e kubit COSO (2013) përbëhet nga një numër komponentësh të ndërlidhur.

Kubi COSO ilustron se si funksionojnë kontrollet e brendshme në tre dimensione, duke e bërë atë shumë fleksibël:

a) Objektivat në lidhje me operacionet, raportimin dhe pajtueshmërinë

b) Komponentët e kontrollit të brendshëm

c) Nivelet e organizatës (si niveli i entitetit ose njësia operative) ku zbatohet kontrolli i brendshëm

b. Diagrami i Kubit COSO



Duke analizuar mjedisin e kontrollit tek Alpha mund te konkludohet se korporata nuk ka nje sistem te kontrollit efikas sepse siq vehet ne shume aspekte ka mjaft rreziqe me te cilat ballafaqohet korporata. Gjithashtu ne Alpha nuk ka nje vleresim te rrezikut per njesi te ndryshme. Gjithashtu te gjitha keto aktivitete nuk kryejne detyren perkatese per te parandaluar rreziqet ne te gjitha nivelet. Siq verehet ne korporate nuk ka nje sistem efikas te informacionit dhe komunikimit gjithashtu. Gjithashtu ne mungese te komiteteve te ndryshme dhe te drejtoreve ekzekutiv nuk ka nje sistem efikas te monitoritmit. Te gjetha keto mangesi jane te shprehura ne te gjitha shtresat e korporates, si ne aspekt te funkcionit po ashtu edhe nje njese te biznesit, divizion apo ne tere entitetin. Kjo eshte e nderlidhur si ne operacione ashtu edhe ne raportim dhe ne pajtueshmeri.

c. Format e kontrollit e cilat mund te instalohen ne Alpha ne departament në departamentin e shitjes jane:

- kontrollimi mbi pranimin e kërkesave
- kontrollet mbi liferimin në kohë të mallrave
- kontrollet mbi faturimet me kohë
- kontrollet mbi të arkëtueshmet
- kontrollet mbi kreditimin e klientëve dhe zbritjeve të mundshme

d.) Tri rreziqe strategjike te Alpha mund te jene:

i. Vendimi per shitje agresive duke përdorur një kampanjë të pabalancuar mes sigurisë së produkteve dhe marketingut në media sociale
ii. Produketet e pakonfirmuara në aspektin e standardeve mjeksore
iii. Vendimi per te filluar procesin e listimit ne berze

Tri rreziqe operacionale jane:

i. Rreziku nga mashtrimet ne financa apo procese te prokurimit
ii. Rreziku nga mos permbushja e obligimeve ligjore tatimore apo te sigurise ne pune
iii. Rreziku nga mospermbushja e obligimve ne lidhje me masat per parandalimin e të drejtave të punësimit të minorenëve dhe keqtrajtimit të kafshëve.

b) Rreziqet te cilat vijne nga kultura DE vijne kryesisht per shkak te mungeses se kultures korporative dhe mungeses se disciplines korporative dhe të një shtytësi tej mase pa konsideruar rreziqet dhe fokusi ne fitim.

Duke u bazuar ne grafin sipas Deal dhe Kennedy (*Kulturat e Korporatës*) me poshte:

		Rreziku I ulët	Rreziku I lart		
Reagimi dhe shpërblimi	I shpejtë	**Kultura - Punoni shumë, luani shumë**	**Kultura macho-djalosh i ashpër**	I shpejtë	Reagimi dhe shpërblimi
	I ngadalshëm	**Kultura e procesit**	**Vini bast kulturën e kompanisë suaj**	I ngadalshëm	
		I ulët	I lart		
		Rreziku			

Mund te konkludohet se DE i takon kuadrantit ku i vijne bast kulturen e kompanise.

Problemi 3

Kërkohet:

a) Duke përdorur matricën e Mendeloë klasifikoni palët e interesit si dhe ndikimi i tyrë në relacion me Korporatën Alpha Fashion. Sqaroni fuqinë dhe interesin e secilës prej tyre? (5 pikë)

c) Spjegoni termet e Qëndryeshmirisë, Gjyrmëve Mjedisore dhe Gjyrmëve Sociale. (5 pikë)

d) Përshkruani se cfarë do të thotë Raportimi i integruar si dhe çfarë përfshijnë raportet ESG, si dhe elaboroni secilë prej tyre në rastin e Alpha Fashion? (5 pikë)

e) Çfarë përfshinë Direktiva e re e BE-së në lidhje me Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatës (CSRD), dhe cka duhet të përfshijë NFRD? (5 pikë)

Totali 20 pikë

Problemi 3.

a) Mendeloë (1991) klasifikon palët e interesuara në një matricë, boshtet e të cilëve janë fuqia e mbajtur dhe gjasat për të treguar një interes në aktivitetet e organizatës. Këta faktorë do të ndihmojnë në përcaktimin e llojit të marrëdhënies që organizata duhet të kërkojë me palët e saj dhe se si duhet t'i shohë shqetësimet e tyre. Matrica e Mendeloë përfaqëson një vazhdimësi, një hartë për vizatimin e ndikimit relativ të palëve të interesuara. Palët e interesuara në pjesën e poshtme djathtas të vazhdimësisë janë më domethënëse sepse ato kombinojnë fuqinë dhe ndikimin më të lartë.

		Niveli i interesit	
		E I ulët ulet	I lartë
Fuqia	E ulët	A	B
	E lartë	C	D

- **Pronaret/akcioneret e Alpha jane lojtarët kryesorë qe** gjenden në Segmentin D.
    - Strategjia e organizatës duhet të jetë e **pranueshme** për ta, të paktën. Gjithashtu edhe një klient i madh eshte ne kete fushe.
- **Qeveria dhe akcioneret institucional** jane palët e interesuara në Segmentin C
    - Ata duhet të trajtohen me kujdes. Ata janë në gjendje të kalojnë në Segmentin D. Prandaj duhet të mbahen të kënaqur.
- **Punetoret. Përfaqësuesit e komunitetit dhe organizatat bamirëse mund të bien në Segmentin B.**
    - Palët e interesuara në Segmentin B nuk kanë aftësi të mëdha për të ndikuar në strategji, por pikëpamjet e tyre mund të jenë të rëndësishme për të ndikuar tek palët më të fuqishme të interesit, ndoshta duke lobuar. Prandaj ata duhet të mbahen të informuar.
- **Klientet e vegjel me pa ndikim apo furnitoret qe mund te zevendesohen lehtesisht.**
    - Përpjekja minimale shpenzohet në Segmentin A.

b) Qëndrueshmëria: Do të thotë të kufizosh përdorimin e burimeve të shterueshme në një nivel që mund të rimbushet. Zhvillimi i qëndrueshëm: Është zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Gjurma mjedisore: Është një masë e ndikimit që aktivitetet e një biznesi të caktuar kanë në mjedis, duke përfshirë burimet e tij, mjedisin dhe emetimet e ndotjes.

Gjurmët sociale: Është një masë e ndikimit ose efektit që një entitet mund të ketë në një grup të caktuar shqetësimesh ose interesash të palëve të interesuara.

ç) Qëllimi i raportimit të integruar (ndonjëherë referuar me këtë simbol: <IR>) është të demonstrojë lidhjen midis strategjisë, qeverisjes dhe performancës financiare dhe kontekstit social, mjedisor dhe ekonomik brenda të cilit biznesi operon . <IR> bazohet në konceptin e të menduarit të integruar. Duke bërë këto lidhje, bizneset duhet të jenë në gjendje të marrin vendime më të qëndrueshme, duke ndihmuar në sigurimin e shpërndarjes efektive të burimeve të pakta. Investitorët dhe palët e tjera të interesuara duhet të kuptojnë më mirë se si një organizatë po performon me të vërtetë. Në veçanti, ata duhet të bëjnë një vlerësim kuptimplotë të qëndrueshmërisë afatgjatë të modelit të biznesit të organizatës dhe strategjisë së saj. <IR> duhet të arrijë gjithashtu thjeshtimin e pasqyrave financiare, duke hequr detajet e tepërta dhe duke theksuar informacionin kritik.

c) Raportimi ESG është shpalosja të dhënave mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative. Si me të gjitha shpalosjet, qëllimi i tij është të hedhë dritë mbi aktivitetet ESG të një kompanie duke përmirësuar transparencën e investitorëve dhe duke frymëzuar organizatat e tjera për të bërë të njëjtën gjë. Meqenëse raportet e ESG përmbledhin përfitimet cilësore dhe sasiore të aktiviteteve ESG të një kompanie, investitorët mund të kontrollojnë investimet, t'i përshtatin investimet me vlerat e tyre dhe të shmangin kompanitë me rrezikun e dëmtimit mjedisor, gabimeve sociale ose korrupsionit. EU – NI duhet te demonstroje nepermjet ketij raporti se cfare eshte duke bere sa I perket invetimeve ne mjedis, investime ne shoqeri dhe ne aspekte te qeverisjes.

d) Direktiva e re e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatës (CSRD) e BE-së, Direktiva e Raportimit Jo-Financiar (NFRD) eshte një standard që përcakton rregullat e shpalosjes për informacionin jofinanciar dhe të diversitetit nga kompanitë e mëdha. Rregullat e NFRD-së kërkojnë që të gjitha kompanitë e mëdha dhe të gjitha kompanitë e listuara të ofrojnë informacionin minimal të mëposhtëm:

   a. Një përshkrim i shkurtër i modelit të biznesit të ndërmarrjes
   b. Rezultati i politikave
   c. Rreziqet kryesore që lidhen me operacionet e ndërmarrjes duke përfshirë: marrëdhëniet e saj të biznesit, produktet ose shërbimet që ka të ngjarë të shkaktojnë ndikime negative në këto fusha; dhe si i menaxhon ndërmarrja rreziqet e tilla
   d. Treguesit kyç të performancës jofinanciare.

Problemi 4.

Më poshte janë dhënë Pasqyra e Pozitës Financiare si dhe Pasqyra e të ardhurave të korporatës për 2022 si dhe 2023.

Pasqyra e Pozitës Financiare

në miliona of EUR

Asetet qarkulluese			
	2022		**2023**
Paraja e gatshme	155		104
Llogaritë e arkëtueshme	360		330
Stoqet	300		257
Totali i aseteve qarkulluese	**815**		**691**
Asetet afatgjata	**4,500**		**4,700**
Totali i Aseteve	**5,315**		**5,391**
Detyrimet afatshkurtëra			
Llogaritë e pagueshme	450		370
Detyrimet tjera afatshkurtëra (<1 vit)	150		70
Totali i detyrimeve afatshkurtëra	**600**		**440**
Kreditë afatgjata	760		770
Totali i detyrimeve	**1,360**		**1,210**
Ekuiteti i pronarit	1,881		1,881
Fitimet e mbajtura	2,074		2,300
Totali i ekuitetit	**3,955**		**4,181**
Totali i detyrimeve dhe ekuitetit	**5,315**		**3,588**

Pasqyra e të ardhurave

në miliona EUR

Në miliona EUR	2022		2023
Shitja	3,450		2,790
Kostoja e mallit të shitur	1,780		1,280
Fitimi bruto	1,670		1,510
Zhlerësimi	200		250
Fitimi para ineresit dhe tatimeve	1,470		1,260
Interesi	141		120
Fitimi para tatimit	1,329		1,140

Kërkohet:

i.) Gjeni koeficientët e kontabilitetit si më poshtë si dhe spjegoni rëndësinë e secilit koeficient në përcaktimin e rrezikut i cili mbartë për biznesin si dhe si ndikon tek palët e interesit:

a) Koeficienti i borxhit (2 pikë)
b) Leverazhi (2 pikë)
c) Mbulesa e interesit (2 pikë)
d) Koeficienti i rrjedhës së parasë (2 pikë)
e) Koeficienti qarkulluese (2 pikë)
f) Koeficienti i shpetësisë (2 pikë)

ii.) Zhvillimi moral kognitiv i Kohlberg dhe Modeli me 5 pyetje i Tucker

Teoritë e zhvillimit moral kognitiv të Kohlberg lidhen me proceset e të menduarit nëpër të cilat njerëzit kalojnë kur marrin vendime etike.

Modeli me pesë pyetje i Tucker i shqyrton vendimet e korporatave duke i shoshitur ato në pesë pyetje.

Duke i perdorur këto dy modele ndërtoni matricen e shqyrtimit të vendimeve të Alpha Fashion?

(8 pikë)

Zgjidhje

Koeficienti i borxhit

$\frac{Total\ borxhet}{Total\ pasuritë} \times 100\%$		
2022		**2023**
(1360/5,315)*100 =26%		(1,210/5,391)*100 = 22%

Reagimi i palëve të interesuara ndaj raportit të borxhit do të jetë i rëndësishëm. Nëse raporti i borxhit duket i rëndë, ofruesit e financimit mund të mos jenë të gatshëm të avancojnë fonde të mëtejshme. Aksionarët mund të jenë të pakënaqur me një barrë të tepruar interesi që kërcënon dividentët dhe vlerën (ndoshta ekzistencën) e investimit të tyre afatgjatë në kompani.

a) Leverazhi (2 pikë)

$\frac{Borxhi\ qe\ permabn\ interes}{Ekuiteti+borxhi\ qe\ eprmban\ interes} \times 100\%$		
2022		**2023**
(910/3,955)*100 =23%		(840/4,181,)*100 = 20%

Aksionarët mund të mos dëshirojnë që dividentët e tyre të kërcënohen nga një barrë e tepruar e interesit, por gjithashtu ata mund të mos jenë të gatshëm të shohin rënien e dividentëve ndërsa kompania përpiqet të ndërtojë bazën e saj të kapitalit. Ata gjithashtu mund të mos jenë të gatshëm (ose të paaftë) të ofrojnë fonde shtesë të kapitalit.

c) Mbulesa e interesit (2 pikë)

$\frac{Fitimi\ para\ interesit\ dhe\ tatimit}{Shpenzimi\ i\ interesit}$		
2022		**2023**
1470 /141=10		**1260/ 120=10.5**

Koeficienti i mbulimit të interesit tregon nëse një kompani po gjeneron fitime të mjaftueshme para interesit dhe tatimeve për të paguar kostot e interesit në mënyrë komode, ose nëse kostot e saj të interesit janë aq të larta sa një rënie në

fitimin para interesit dhe tatimit do të kishte një efekt të rëndësishëm në fitimet e disponueshme për aksionerët e zakonshëm.
Një mbulim i interesit trefish ose më pak konsiderohet përgjithësisht si shqetësues i ulët.

b) Koeficienti i rrjedhës së parasë (2 pikë)

$\frac{Rrjedhat\ neto\ hyrese}{Total\ borxhet}$		
2023		
1,383/1210=1.14		

Një shifër e ulët për raportin e rrjedhës së parasë mund të mos jetë një shqetësim i veçantë nëse pjesa më e madhe e borxhit duhet të shlyhet një kohë të gjatë përpara. Aksionarët dhe ofruesit e financimit do të jenë më të shqetësuar për aftësinë e kompanisë për të përmbushur kreditë e saj afatshkurtra dhe rreziqet që mund të kërcënojnë hyrjet e parave të nevojshme për të shlyer shumat e borxhit.

c) Koeficienti qarkulluese (2 pikë)

$\frac{Pasuria\ qarkulluese}{Detyrimet\ afatshkurta}$		
2022		**2023**
815/600 = 1.35		691/**440= 1.40**

Koeficienti qarkulluese është një tregues kyç i likuiditetit, sasia e parave të gatshme në dispozicion të një kompanie për të shlyer shpejt borxhet e saj.
Një kompani duhet të ketë pasuri të mjaftueshme qarkulluese që japin një premtim për "para të gatshme" për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurta. Edhe pse mund të pritet një raport mbi 1, në shumë industri bizneset operojnë pa probleme me raportet nën 1.

g) Koeficienti i shpetësisë (2 pikë)

$\frac{Pasuria\ qarkulluese\ minus\ stoqet}{Detyrimet\ afatshkurta}$		
2022		**2023**
515/600 = 0.85		**434/440= 0.98**

Koeficienti i shpejtësisë pasqyron faktin se disa kompani mund të mos jenë në gjendje të konvertojnë shpejt stoqet në para. Stoqet nuk janë pasuri shumë likuide dhe kështu mund të shtrembërojë koeficientin qarkulluese nëse përdoret për të vlerësuar likuiditetin.

Koeficienti i shpejtësisë, ose koeficienti i testit acid, idealisht duhet të jetë të paktën 1 për kompanitë me një qarkullim të ngadaltë të istoqeve. Për kompanitë me një qarkullim të shpejtë të stoqeve, një koeficient i shpejtësisë mund të jetë lehtësisht më i vogël se 1 pa sugjeruar që kompania mund të ketë probleme me rrjedhën e parasë.

ii) Zhvillimi moral kognitiv i Kohlberg

Niveli 1: Para-konvencional (shpërblime/dënim/interes vetjak)

Vendimet që marrin individët për çështjet etike nuk do të kenë të bëjnë fare me çështjet etike të përfshira, por përkundrazi do të varen nga avantazhi ose disavantazhi personal për individin. Ketu kemi te bejme ne rastin e Alpha ku akcioneret dhe menaxheret e larte e shohin veten interesin personal dhe fitimin personal

Niveli 2: Konvencional

Kjo fazë mund të përkufizohet si individë që mësojnë të jetojnë sipas asaj që pritet prej tyre nga rrethi i tyre i ngushtë (miqtë, shokët e punës apo edhe konkurrentët e ngushtë). Kjo mund të funksionojë në të dyja mënyrat në një kontekst biznesi.

Ne kete rast Alpha pritet te sjelljet sipas normave dhe ligjeve ne vend si dhe te mos beje shkelje te ligjeve.

Niveli 3: Post-konvencional

Niveli më i avancuar lidhet me zhvillimin individual drejt marrjes së vendimeve të tyre etike për sa i përket asaj që ata besojnë se është e drejtë, jo vetëm pranimit të asaj që të tjerët besojnë se është e drejtë. Sipas sjelljeve te Alpha nuk duket se bordi dhe menaxhmenti te kene perqafuar nivelin post konvencional meqerast do te investonin dhe do te perqafonin filozofine e CSR dhe zhvillimit te qendrueshem.

Matrica e Alpha duke u bazuar në modelin e Tucker në pesë pyetje.

A është vendimi:	
Profitabil?	Krahasuar me çfarë? Përdorimi i përfitimit si kriter nënkupton gjithashtu se modeli Tucker mund të jetë më i dobishëm për vendimet e biznesit sesa për dilemat morale të individëve
Ligjor?	Kjo padyshim varet nga juridiksioni(et) e përfshirë
Fer?	Në këndvështrimin e kujt? Duhet të merret parasysh kush janë palët e interesuara dhe ndikimi i vendimit mbi ta
I drejtë?	Kjo varet nga pozicioni etik; në veçanti dallimi ndërmjet qasjeve deontologjike dhe teleologjike nëse duhen marrë parasysh pasojat e transaksionit është i rëndësishëm.
I qëndrueshëm?	A është vendimi i shëndoshë mjedisor apo i qëndrueshëm në mënyra të tjera?

Totali 20 pikë

Problem 5.

Metoda IRR

i.) Një kompani po përpiqet të vendosë nëse do të blejë një makinë për 80,000 euro, e cila do të kursejë kostot prej 15,000 euro në vit për pesë vjet dhe e cila do të ketë një vlerë rishitëse prej 7,000 euro në fund të vitit 5. Nëse politika e kompanisë është të ndërmarrë vetëm projekte nëse pritet të japin një kthim DCF prej 8% ose më shumë, konstatoni nëse ky projekt duhet të ndërmerret? (15 pikë)

Zgjidhja:

Viti	***Rrjedha e parasë***	**VNT 8%**
0	**-80,000**	**-80,000**
1	**15,000.00**	**13,889**
2	**15,000.00**	**12,860**
3	**15,000.00**	**11,907**
4	**15,000.00**	**11,025**
5	**15,000.00**	**10,209**
6	**7,000.00**	**4,411**
VTN		**-15,698**

Meqenese vlera eshte negative atehere ky project nuk duhet te ndermirret.

ii) Cilat jane kërcënimet etike ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore për auditorët e jashtëm të angazhuar në Alpha Fashion në situatën e përshkruar. Duke përdorur formatin e tabelës më poshte përshkruani kërcimet dhe shembullin përkatës. (5 pikë)

Kërcënimi	Shembulli
Familjariteti	**Meqenese DE bene perzgjedhjen e Auditoreve, ka shume gjasa qe auditoret te kene krujuar nje lidhje te familjaritetit pasi qe shihet se kjo ceshtje eshte ne dirkrecion te DE. Ketu ekziston rreziku qe per shkak te perfimit te raporeteve te favorshme ai bene selektimin e auditoreve me te cilet ka krijuar marredhenie te aferta.**
Kërcënimi i frikësimit	**Për shkak të tarifës shumë të lartë auditorët ndihen të kërcnuar se mund të humbasin një shumë të madhë të hyrave.**
Kërcënimi i frikësimit	**Tarifat e vonuara** **Në një situatë ku ka pagesa të vonuara të tarifave, auditori ka rrezik që, efektivisht, t'i japë hua ose kredi një klienti, dhe kjo ndodh në rastet kur, sipas udhëzimeve të dhëna më sipër shumat e papaguara janë relevante.**
Kërcënimi i interesit vetjak	**Përqindje e lartë e tarifave** **Tarifat e auditimit të paguara ishin jashtzakonisht të mëdha** **Secila firmë duhet të jetë syhapur ndaj situatave të cilat dalin në pah në rastet kur tarifat totale të gjeneruara [përftuara] prej një klienti të cilit i jepen shërbime sigurie paraqesin një pjesë të madhe të tarifave totale të firmës. Faktorë të tillë si struktura e firmës dhe gjatësia e kohës në të cilën palët, pra, firma [e auditimit] dhe kompania [klient] kanë punuar me njëra tjetrën janë të rëndësishme në përcaktimin e faktit nëse ka apo jo një kërcënim ndaj pavarësisë**
Kërcënimi i vetë-rishikimit	**Disa prej auditorëve ishin angazhuar edhe në shërbime të vlerësimit në disa njësi biznesi të Alpha** **Kërcënimet e vetë - rishikimeve ndodhin në rastet kur një gjykim i mëhershëm duhet të ri – vlerësohet prej anëtarëve të cilët ishin përgjegjës për bërjen e vetë gjykimit në fjalë.**

Totali 20 pikë